



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 4945/Prot.
1

Tiranë, më 07.072021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.126/1, datë 11.01.1995.

SHOQERISË “KUMEGA” SHPK
LAGJIA PARTIZANI, RRUGA “KUVENDI I DUKAGJINIT”, BURREL.

**Për dijëni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “KUMEGA” sh.p.k, është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.126/1, datë 11.01.1995, për mineral kuarci, në objektin “Dukagjin”, Bashkia Mat, Qarku Dibër.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2373, datë 15.06.2021 (Nr.4945, Prot. MIE, datë 15.06.2021), është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.126/1, datë 11.01.2021, për mineral kuarci, në objektin “Dukagjin”, Bashkia Mat, Qarku Dibër, **sepse në objekt nuk punohet, subjekti ka pezulluar veprimtarinë minerare pa njoftuar me pare (jo me vonë se 90 ditë kalendarike strukturat përgjegjëse për veprimtarinë minerare).**

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave**

të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.126/1, datë 11.01.1995, për mineral kuarci, në objektin “Dukagjin”, Bashkia Mat, Qarku Dibër, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit Nr.126/1, datë 11.01.1995, për mineral kuarci, në objektin “Dukagjin”, Bashkia Mat, Qarku Dibër.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA**

